

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 4206 Rep.

Nr. 1495 Kol.



**KONTRATE**

**(Për transferimin e kuotave të shoqërisë "Eurocol" Shpk.)**

Sot në Tiranë me datë 17.11.2005, përpara meje noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme:

**SHITESI:** Z. Robert Kasneci, lindur me 11.12.1953 në Tiranë, banues në Tiranë në adresën Rr.Sulejman Delvina P.Ri, Nr.7/1, identifikuar me pasaportën nr. NF 490685, madhor e me zotësi të plote për të vepruar i njohur personalisht prej meje noterit.

**Dhe**

**BLERESI:** Z. Pandeli Carapuli, lindur me 23.07.1953 në Tiranë, banues në Tiranë në adresën Rr.Budi, Pall. Classic Konstruksion, Sh.2, Ap.40, identifikuar me pasaportën nr. Z0184436, madhor e me zotësi të plote për të vepruar i njohur personalisht prej meje noterit.

**MEQENESE**

- a) Shitësi zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë "Eurocol" Shpk. (Shoqëria), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me vendimin nr. 8219 datë 24.11.1993 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
- b) Blerësi është ortak në Shoqëri dhe zotëron 50% të kapitalit të shoqërisë;
- c) Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi t'i shesë Blerësit të gjitha kuotat që zotëron në shoqëri të cilat përbejnë 50% të kapitalit të Shoqërisë;
- d) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi kuotat e specifikuara me sipër;
- e) Kuotat shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë.

Meqenëse ekzistojnë kushtet me sipër, palët bien dakord për sa me poshtë vijon:

### 1. Objekti i Kontratës

Sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë, Shitësi transferon tek Blerësi dhe ky i fundit blen nga Shitësi të gjitha kuotat që Shitësi zoteron në shoqëri të cilat përbejnë 50% të kapitalit të Shoqërisë;

### 2. Çmimi i shitjes

Kuotat shiten (transferohen), kundrejt vlerës së tyre nominale prej Lek 640.000 (gjashtëqind e dyzet mijë), çmim i cili është paguar plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

### 3. Transferimi i pronësisë mbi kuotat

Pronësia mbi kuotat transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

### 4. Te ndryshme

Pas transferimit të pjesëve të kapitalit tek Blerësi, Z. Pandeli Carapuli, behet pronar i ligjshëm i 100% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë ndërsa Shitësi e humbet pronësinë mbi kuotat e kapitalit të Shoqërisë.


### 5. Baza Ligjore

Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 7638 datë 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare" si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore të cilës i behet referim në këtë kontratë.

Kjo kontratë pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet në përputhje me vullnetin e lire e të plote të palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time në katër kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.



SHITESI

Robert KASNECI

  
Robert Kasneci

BLERESI

Pandeli CARAPULI

NOTERI



NOTERI  
ARIANA M. MALLKUÇI  
Tel. Zyrt. 250253,266242